



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:164301

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05714739

**C.nr.1030/2023**

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gazmend Ajvazi, dhe bashkëpunëtoren profesionale Adelina Shabani, në çështjen juridike të paditëses K. e Sigurimeve “S.”, me seli në P., Rr.”Q. H.” nr51, ndaj të paditurit A. (Sh.) S. nga Gj., Rr. “ P. A. ” nr. 52, me objekt kontesti rimbursim i dëmit material dhe jomaterial, vlera e kontestit 17,630.25 euro, jashtë seance gjyqësore, më datën 21.05.2024, morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

**(Në bazë të padëgjueshmërisë/ mosbindjes)**

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses K. e S. “S.”, me seli në P..

II. DETYROHET i padituri A. (Sh.) S., nga Gj., që në emër rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 01.01.2014 në Gj., t’ia paguaj paditëses shumë prej 17,630.25 euro, edhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vitë pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 40.00 euro, në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Paditësja pranë kësaj gjykate më datë 31.07.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurit, me objekt kontesti rimbursimin i dëmit material dhe jomaterial, me vlerë të objektit të kontestit 17,630.25 euro, duke theksuar që i padituri me datë 01.01.2014, rreth orës 20:30 h, në rrugën njëkahëshe “H. T.”, në lagjen “D.” në Gj., ka shkaktuar aksident trafiku me automjetin “BMW”, me targa të regjistrimit 06-477-BH, i cili për shkak të mos përvojës në vozitje - pa patentë shofer, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, duke humbur kontrollin, ku si pasojë e këtij aksidenti janë shkaktuar dëme materiale dhe jomateriale. Më tutje ka shtuar se paditësja palët e dëmtuara u ka kompensuar shumë prej 17,630.25 euro, për kategoritë e dëmit material dhe jomaterial. Nga arsyet e cekura më lartë, dhe referuar dispozitës së nenit 14 pika 1.2 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tersi kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet i padituri që paditëses t’ia rimbursoj shumë prej 17,630.25 euro, në emër të dëmit të shkaktuar në

aksidentin e datës 01.01.2014, së bashku me kumatën ligjore, ashtu siç paguajnë bankat afariste mbi një vit pa destinim të veçantë, prej datës së paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë në bazë të nenit 387 par.1, pika (a), ka nxjerrë Aktvendimin C.nr./23, të datës 13.09.2023 të cilën i padituri së bashku me të gjitha shkresat e lëndës, e ka pranuar me datë 29.09.2023, fakt ky i vërtetuar përmes fletëkthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurit për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë i njëjti nëse nuk paraqet përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes në disfavor të tij.

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar personalisht aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestimore, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë/ mosbindjes, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, paragrafi 1 pika a), b) dhe c) të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim LPK), në të cilën dispozitë shprehimisht parashket se “*Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimin për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht*”.

Në rastin konkret dhe në kuptim të dispozitës së cekur më lartë, rezulton se themelësia e kërkesëpadisë së paditëses del nga faktet e treguara në padi dhe nga provat që i janë bashkangjitur padisë, në bazë të Raportit Policor dhe nga skica e vendit të aksidentit sipas numrit të rastit 2014-CR-001, konstatohet se i padituri më datë 01.01.2014 ka shkaktuar aksident dhe deri te aksidenti ka ardhur si pasojë që i padituri duke drejtuar automjetin e markës Xhip “BMË”, me targa të regjistrimit 06--BH, i cili ishte duke lëvizur në rrugën njëkahëshe, në rr. “H.T.” në drejtim të ambulancës “D. I”, me të arritur në afërsi të autolarjes “R.”, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes të automjetit të tij në vendbanim, si dhe duke mos pasur eksperiencën e duhur për ngasje të automjetit pa patentë shofer, me pjesën e majtë të automjetit e godet këmbësorët S. M. dhe S.M., të cilët në momentin kritik ishin duke trupuar rrugën, nga ana e djathtë në të majtë të rrugës, në anën e kundër të veturës MBË X5, të cilët kishin pësuar lëndime të rënda trupore. Dhe si rezultat e si rezultat i këtij aksidenti, paditësja K.S. ”S.” i dëmtuari S. M. përmes përfaqësuesit të tij, kanë nënshkruar rekomandimin për përmbushje vullnetare më datë 10.03.2023, ashtu që në emër të kompensimit të dëmit jo material është

rekomanduar shuma prej 14,708.25 euro, të cilën shumë paditësja të dëmtuarit i' a ka paguar më datë 31.03.2023, e po ashtu edhe në emër të kompensimit të dëmit material paditësja të dëmtuarit i ka kompensuar shumën prej 2,922.00 euro, të cilën paditësja e ka paguar më datë 27.06.2023.

Gjykata për marrjen e këtij vendimi gjithashtu është mbështetur në dispozitat e nenit 960, par.1 të LMD-së, ku theksohet se *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave të cilët mbi çfarë do baze janë përgjegjës për dëmin”* dhe në dispozitën e nenit 14 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku shprehimisht thuhet se *“ I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur: 1.2. “Drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimeve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit”* 2. Humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohen me dispozitat e paragrafit 1. nën-paragrafët 1.1 deri 1.5, të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim. 3. Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese.”, e në rastin konkret i padituri në momentin e aksidentit ka qenë pa patent shofer, kurse lidhur me dëmin e shkaktuar nga i njejt, paditësja e ka kompensuar dëmin e shkaktuar personit të tretë, këtu të dëmtuarit A.R., gjë që paditëses në bazë të dispozitave të sipërcekura i ka lindur e drejta që të kërkojë nga i padituri rimbursimin e shumës së kompensuar personit të tretë, kurse të paditurit i ka lindur detyrimi për pagesën e shumës së sipercekur paditëses nga kjo bazë juridike.

Meqenëse i padituri në momentin e shkakimit të aksidentit, ka qenë pa mbulesë siguruese, respektivisht pa patentë shofer, ndërsa paditësja konform diapozitave të cekura më lartë ia ka kompensuar dëmin e shkaktuar nga i padituri të dëmtuarit këtu S. M., paditësja në bazë të nenit 14 para.1 pika 1.2 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ka të drejtë regresi për dëmin e shkaktuar nga personi përgjegjës, në këtë rast i padituri për shumën e paguar palës së dëmtuar, andaj nga këto arye gjykata e aprovoj kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cekura ligjore nga neni 150 i LPK-së e në lidhje me dispozitat nga neni 245, paragrafi 1 LMD-së i Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-077, ku përcaktohet se *“ Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”,* dhe neni 169 par.1 i cili thotë se *“ Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”* dhe par.2 *“Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla”,* por edhe sipas doktrinës juridike shuarja e detyrimit me anë të përmbushjes është mënyra më e natyrshme e realizimit të presimit nga ana e debitorit. Kur përmbushja (ekzekutimi) bëhet në mënyrën e duhur dhe në afatin e caktuar, atëherë është arritur qëllimi i detyrimit, kreditori e ka realizuar të drejtën e tij dhe detyrimi pushon se ekzistuar – shuhet, andaj mbi bazat e

lartëcekura gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Meqë i padituri ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me shkresat e lëndës, ndërsa nuk ka kthyer përgjigjen në padi, ndërsa faktet e treguara në padi mbështeten në provat e theksuara si më lartë dhe kërkesa është e themeltë bazuar dispozitave ligjore të LMD-së, gjykata vendosi që të nxjerrë aktgjykim pa konvokuar shqyrtim gjyqësor, duke aprovuar kërkesën e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak të plotësisimit të kushteve të parapara në nenin 150 të LPK-së.

Gjykata vendosi për kamatën duke u bazuar në kërkesën e palës paditëse, duke e obliguar të paditurin që nga data e ushtrimit të padisë të paguaj kamatëvonesën si dhe për mjete e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimre, gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke e aprovuar shumën prej 20 euro për taksë gjyqësore për padinë e paraqitur.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 150 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr.1030/2023, datë 21.05.2023**

**Gjyqtari,**  
**Gazmend Ajvazi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.